

# HYRJE NË TË DREJTAT DIXHITALE

---



## PËRMBAJTJA:

<b>HYRJE</b>	<b>2</b>
<b>MBROJTJA E TË DHËNAVE</b>	<b>3</b>
Mbrojtja e të dhënave personale në hapësirën dixhitale	4
Shembuj të shkeljeve të të drejtave	4
Pasojat për individin dhe shoqërinë	5
Mekanizmat për mbrojtje	5
<b>SIGURIA DIXHITALE</b>	<b>6</b>
Siguria në hapësirën dixhitale	7
Shembuj të shkeljeve të të drejtave	7
Pasojat për individin dhe shoqërinë	8
Mekanizmat për mbrojtje	8
<b>LIRIA E SHPREHJES</b>	<b>10</b>
Liria e shprehjes në hapësirën dixhitale	11
Shembuj të shkeljeve të të drejtave	11
Pasojat për individin dhe shoqërinë	12
Mekanizmat për mbrojtje	12
<b>TË DREJTAT DIXHITALE NË RAJON</b>	<b>13</b>

# HYRJE

Të drejtat e njeriut zbatohen në mënyrë të barabartë si në internet ashtu edhe në hapësirën fizike.

Teknologjitë dixhitale kanë hapur rrugë të reja dhe interesante për shprehjen e ideve, shkëmbimin e informacionit, shoqërimin, protestën dhe për aktivitete të tjera të ngjashme të qytetarëve të lirë, të cilat njihen si të drejta themelore të të gjithë njerëzve. Këto të drejta janë nën mbrojtje universale dhe i përkasin të gjithëve, pavarësisht prejardhjes, statusit apo dallimeve të tjera.

Dixhitalizimi i punëve të përditshme dhe komunikimit njëkohësisht ka mundësuar edhe zhvillimin e mjeteve për abuzim dhe shkelje të të drejtave. Me vetëdije ose nga injoranca, të shtyrë nga interesa komerciale apo nga qëllimi për të vendosur kontroll, aktorë të ndryshëm - shtete, korporata, organizata politike dhe organizata të tjera - janë shpesh autorë të censurës, shkeljeve të privatësisë dhe diskriminimit mbi baza të ndryshme.

Megjithëse shumica e njerëzve në internet dinë të përdorin pajisje inteligjente dhe të shkarkojnë e publikojnë përmbajtje në platformat online, nuk është gjithmonë e qartë se cilat nga këto aktivitete i përkasin domenit të mbrojtjes, apo në cilat raste mund të flasim për shkelje të të drejtave. Kështu për shembull, si në Twitter, opsioni 'ndaj' në Facebook ose të dhënat meta të Kërkimit në Google - A janë ato informacione personale? Kur kufizimi i qasjes në një faqe kthehet në censurë? Cilat të drejta themelore të njeriut kërcënohen gjatë përpunimit masiv të të dhënave biometrike në sistemet inteligjente? A mund të jetë diskriminues procesi i vendimmarrjes algoritmike të automatizuar?

Në mënyrë që qytetarët dhe organizatat qytetare të mund t'u përgjigjen këtyre dhe shumë pyetjeve të tjera që na presin me aplikimin më të gjerë të teknologjive edhe më komplekse, ata kanë nevojë për njohuri mbi të drejtat digjitale - të drejtat e njeriut në mjedisin dixhital. Kështu, ky manual i ilustruar me shembuj praktikë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor paraqet disa nga konceptet bazë në këtë fushë.



## MBROJTJA E TË DHËNAVE

Nocioni i mbrojtjes së të dhënave rrjedh nga një e drejtë themelore e njeriut – e drejta për privatësi. E drejta për jetën private nënkupton kontroll mbi informacionin për veten, d.m.th. kontroll nëse dhe kush do të dijë se cilat vende ne po vizitojmë, çfarë po blejmë, ku po jetojmë dhe me kë kemi korrespondencë. Privatësia është e një rëndësie të padryshueshme për jetën autonome të çdo individi dhe me ardhjen e internetit rrezikimi i saj po bëhet gjithnjë e më i dukshëm.

## MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË HAPËSIRËN DIXHITALE

Me zhvillimin e teknologjisë ka pasur një fluks dhe shumëzim edhe të madh të të dhënave, shumica e të cilave janë të dhëna personale. Pra, informacione që kanë të bëjnë me një person specifik që mund të identifikohet. Mbrojtja e të dhënave ka të bëjë pikërisht me rregullimin e përpunimit të të dhënave (mbledhjes, përdorimit dhe ruajtjes së tyre) në shërbim të mbrojtjes së privatësisë së individëve në hapësirën dixhitale. Sot, të dhënat personale konsiderohen si një burim i vlefshëm në bazë të të cilit kompanitë krijojnë fitime dhe shtetet ushtrojnë kontroll mbi qytetarët. Kështu, ruajtja e privatësisë në epokën dixhitale po përballlet me sfida shtesë. Nëse të dhënat nuk mbrohen siç duhet, nëse ato rrjedhin ose keqpërdoren, privatësia jonë rrezikohet.

### SHEMBUJ TË SHKELJEVE TË TË DREJTAVE

- Në rrjetet sociale ka nisur të qarkullojë një dosje me të dhëna personale të mbi 5 milionë qytetarëve të një vendi. Procesi mbikëqyrës përcaktoi se dosja e të dhënave fillimisht ishte publikisht e disponueshme në faqen e internetit të një agjensie shtetërore nga e cila edhe u shkarkua. Agjensia në fjalë u mbrojt duke pretenduar se kjo ka ndodhur përmes aksesit të paautorizuar në serverin e tyre.
- Të dhëna të tilla si emrat, numrat e telefonit dhe vendndodhjet e mbi gjysmë miliardë llogarive nga një rrjet social u zbuluan në një forum hakerësh. Megjithatë, rezultoi se kjo rrjedhje nuk ishte një çështje gabimi, por se të dhënat ishin nxjerrë qëllimisht me ndihmën e një softueri të posaçëm i cili u bë i mundur për shkak të dështimit sistematik të rrjetit social.
- Një organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ka marrë lista të më shumë se 50,000 telefonave celularë që dyshohet se janë objektiva të spiunazhit të mundshëm me ndihmën e një softueri që komprometon telefonin, nxjerr të gjitha të dhënat dhe aktivizon një mikrofoni që regjistron bisedat.
- Në aplikacionin Telegram dhjetëra mijëra burra nga rajoni shkëmbyen përmbajtje intime, p.sh. fotografi, video dhe foto të grave, duke përfshirë edhe të mitur. Anëtarët e grupeve marrin përmbajtjen ose nga partnerët e tyre në të kaluarën ose thjesht "shkarkonin" ato

nga rrjetet sociale dhe ua dërgonin grupeve, shpesh me zbulimin e të dhënave personale të grave.

- Mediat në një vend publikuan detajet e një databaze të madhe që përmban të dhënat personale të më shumë se 910,000 votuesve. Në listë janë përfshirë edhe gazetarë, aktivistë dhe persona të tjerë të njohur. Dyshohet se këto të dhëna i janë dhënë një partie politike për t'i përdorur gjatë fushatës zgjedhore.

## PASOJAT PËR INDIVIDIN DHE SHOQËRINË

Të merresh me mbrojtjen e të dhënave është thelbësore për të parandaluar ose të paktën për të sanksionuar në mënyrë adekuate shkeljet e të dhënave si rrjedhjet, mbikëqyrjen e paligjshme të komunikimeve ose përpunimit të paautorizuar të të dhënave. Nëse situata të tilla si vjedhjet e numrave të kartave bankare apo mbikëqyrja e bisedave në rrjetet sociale do të ishin të parregulluara, është e qartë se do të jetonim në një botë ku do të mbretëronte frika dhe ku të gjithë do të ishim më pak të lirë. Përveç kësaj, më të marginalizuarit mes nesh do të kërcënoheshin edhe më shumë, p.sh. nëse kompanitë do të kishin të drejtë të përpunonin pa pengesë të dhëna të ndjeshme si raca ose gjinia, ato të dhëna do të mund të përdorehin për qëllime diskriminuese.

## MEKANIZMAT PËR MBROJTJE

- E drejta për t'u informuar - kompanitë dhe organizatat janë të detyruara të shpjegojnë se cilat të dhëna përpunojnë, d.m.th. ne kemi të drejtë të dimë se cilat të dhëna për ne janë mbledhur dhe si përdoren.
- E drejta e qasjes - organizatat janë të detyruara të lëshojnë një kopje të informacionit që ata kanë mbi ne.
- E drejta për korrigjim - ne kemi të drejtë të korrigjojmë të dhëna të pasakta ose të plotësojmë të dhëna jo të plota.
- E drejta e fshirjes, pra e drejta për t'u harruar - kjo e drejtë ushtrohet në raste të ndryshme si përpunimi i paligjshëm i të dhënave ose kur qëllimi i përpunimit të të dhënave nuk ekziston më.
- Nëse një kompani ose një organizatë dëshiron të përpunojë të dhëna që nuk janë të nevojshme për ofrimin e një shërbimi të caktuar ose nuk parashikohen me ligj, ata duhet të marrin pëlqimin tonë për atë përpunim dhe ne gjithmonë kemi të drejtë ta tërheqim atë pëlqim.

Në këtë [vegëz](#) ju mund të shikoni videon tonë të shkurtër mbi mbrojtjen e të dhënave.



## **SIGURIA DIXHITALE**

Ne mund t'i qasemi sigurisë si një aspekt jashtëzakonisht i rëndësishëm për jetën e individëve, pasi që ajo përfaqëson një formë rezistence ndaj një ngjarjeje ose sjellje të tjerëve që mund të jetë kërcënuese, pra përfaqëson një mbrojtje të caktuar ndaj gjërave që mund të na dëmtojnë. Përveç faktit që siguria mund të diskutohet në kontekst individual, për shembull nëse anëtarët e një pakice seksuale mund të ecin lirshëm në rrugë pa frikën e dhunës fizike, siguria mund të diskutohet edhe në nivelin e një organizate apo shteti.

## SIGURIA NË HAPËSIRËN DIXHITALE

Sulmet kibernetike dhe krimi kibernetik po bëhen gjithnjë e më të pranishme dhe me shumë gjasë që numri dhe sofistikimi i tyre do të vazhdoj të rritet në të ardhmen. Kjo kërkon trajtimin e sigurisë në kontekstin dixhital dhe nevojën që të punohet vazhdimisht në ndërtimin e elasticitetit të sistemeve të informacionit dhe rezistencës ndaj sulmeve dhe dëmtimeve të mundshme. Kështu shumë aktivitete themelore të shteteve dhe kompanive janë përhapur në hapësirën kibernetike. Nëse pranojmë se sektorë të tërë si transporti, energjia, shëndetësia etj. janë të varur nga teknologjitë dixhitale, është e qartë se kjo i bën ata në një mënyrë më të brishtë - domethënë, e gjithë shoqëria dhe ekonomia janë të ekspozuara ndaj sulmeve që tani mund të jenë edhe të natyrës dixhitale. Individët gjithashtu mund të jenë objektiv i sulmeve kibernetike, për shembull, nëse na mohohet qasja në llogaritë tona në platforma të ndryshme, kjo mund të jetë një shenjë se privatësia dhe qasja jonë në të dhënat personale janë nën kërcënim, dmth që dikush ka marrë në zotërim fjalëkalimet tona. Interneti gjithashtu mund të na ekspozojë ndaj ngacmimeve ose ndjekjeve të mundshme, të cilat mund të bëhen përmes llogarive të rreme ose anonime.

### SHEMBUJ TË SHKELJEVE TË TË DREJTAVE

- Një faqe interneti u hakua disa orë pas publikimit të temës së doktoraturës plagjiaturë e një zyrtari shtetëror. Sulmet ndaj sajtit vazhduan edhe gjatë javës së ardhshme dhe administratorët e faqes informuan publikun se ata kishin qenë nën sulme kibernetike për disa vite me radhë për shkak të përmbajtjes së tyre të papërshtatshme politikisht.
- Një komunë lëshoi një deklaratë se arkivi i tyre ishte sulmuar nga një virus që bllokoi dokumente, d.m.th pengon qasjen në to. Virusi u citua si arsyeja pse komuna nuk mundi t'u lëshojë asnjë dokument qytetarëve dhe problemi u zgjidh brenda pak ditësh. Megjithatë, nuk është e qartë nëse të dhënat janë vjedhur ndërkohë.
- Një ditë pas zgjedhjeve një faqe interneti e komisionit zgjedhor të një vendi ishte shënjestër e një sulmi hakerësh për tre orë. Sulmi nuk shkaktoi dëme të mëdha sistematike, por vonoi shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve.
- Disa mijëra kompjuterë të infektuar sulmuan serverët e portaleve që publikonin lajmet për privilegjet e vajzës së guvernatorit të Bankës Kombëtare të një vendi. Faqet në të cilat u publikua lajmi treguan se



gabimi 404 Nuk u Gjet, që tregon se përmbajtja e kërkuar nuk ekziston në adresën e dhënë të internetit.

- Një person anonim regjistroi një profil në një rrjet social me emrin dhe mbiemrin e një profesori të njohur dhe të respektuar në komunitetin e tij lokal. Përmes këtij profili më pas u kërkuar donacione financiare. Pasi profesori tregoi se dikush i kishte vjedhur identitetin e tij në këtë rrjet social, profili në fjalë u pezullua.
- Kryetari i një qyteti nuk mundi të hynte në profilin e tij në një rrjet social për ditë të tëra. Kështu që ai informoi mbështetjen e klientëve për një sulm të mundshëm hakerësh.
- Duke i atribuar citate që nuk i kishte thënë kurrë, për të promovuar shërbime të lidhura me kriptovalutat, mashtruesit përdorën emrin dhe fotografinë e drejtorit të një banke të madhe.

## **PASOJAT PËR INDIVIDIN DHE SHOQËRINË**

Nëse nuk punojmë për forcimin e sigurisë dixhitale, si në nivel individual ashtu edhe në atë organizativ, efektet e sulmeve me qëllime të këqija mund të shkaktojnë dëme në rritje të individëve dhe të shoqërive të tëra. Megjithatë shumë nga proceset që ndodhin në hapësirën kibernetike prekin një numër të madh njerëzish, pasojat e sulmit ndaj tyre janë potencialisht më të gjera. Edhe pse të gjithë ne mund të jemi nën kërcënim nga sulmet kibernetike, kur flasim për sigurinë kibernetike, pra sigurinë dixhitale, ashtu si kur bëhet fjalë për sigurinë në hapësirën fizike, disa anëtarë të shoqërisë janë më të cenuar se të tjerët. Anëtarët e kategorive të veçanta - p.sh. gazetarët që merren me informacione të ndjeshme, janë një objektivi më i shpeshtë i sulmeve kibernetike. Duke sulmuar këta gazetarë dhe duke hequr përmbajtje apo duke vjedhur të dhëna të ndryshme, hakerët prekin jo vetëm përfaqësuesit e këtij grupi, por të gjithë shoqërinë e gjerë.

## **MEKANIZMAT PËR MBROJTJE**

- Për t'u mbrojtur nga "malware", një lloj softueri që mund të vjedhë ose bllokojë të dhënat, përveç instalimit të softuerit që mund t'i identifikojë ato, është thelbësore të mos hapni email nga adresa të dyshimta, të mos instaloni programe të paverifikuara dhe të mos u besoni faqeve jo të besueshme.
- Është e nevojshme të keni një fjalëkalim të ndryshëm për çdo llogari

dhe ai të jetë i gjatë dhe të përbëhet nga karaktere dhe simbole të ndryshme.

- Vërtetimi me dy nivele për llogaritë, që njihetsi 'Two-level authentication', është një verifikim i dyfishtë i identitetit dhe përfaqëson një pengesë shtesë për hakerët.
- Duhet të përdorim aplikacione të besueshme dhe t'i përditësojmë ato rregullisht.

Në këtë [vegëz](#) ju mund t'i qaseni videos tonë të shkurtër mbi sigurinë dixhitale.

Për më shumë mjete që mund të forcojnë sigurinë tuaj dixhitale, ju mund të vizitoni këtë [faqe](#).



## LIRIA E SHPREHJES

Liria e shprehjes nënkupton lirinë për të shprehur mendime dhe ide të ndryshme pa frikë apo ndërhyrje, por gjithashtu përfshin qasje të lirë në informacion pa ndërhyrje nga shteti apo subjekte të tjera. Megjithatë, kjo e drejtë nuk duhet kuptuar si absolute, pasi mbart edhe detyra edhe përgjegjësi dhe i nënshtrohet kufizimeve si ndalimi i gjuhës së urrejtjes.

## LIRIA E SHPREHJES NË HAPËSIRËN DIXHITALE

Me ardhjen e internetit, komunikimi mes njerëzve është rritur, veçanërisht duke pasur parasysh që ne mund të komunikojmë me më shumë njerëz në të njëjtën kohë dhe se ata mund të jenë të vendosur në kontinente të ndryshme. Përveç kësaj, interneti poashtu na lejon edhe një sasi të caktuar të anonimitetit. Kështu për shembull, ne mund të krijojmë profile që nuk zbulojnë identitetin tonë dhe të komunikojmë më lirshëm në hapësirën kibernetike duke besuar se pasojat e sjelljes në internet nuk kanë pse të kenë të njëjtin efekt sikurse në sferën fizike! Problem tjetër serioz që kufizon një pjesë të lirisë së shprehjes në internet, drejtuar nga shtete dhe korporata të ndryshme, është edhe censura që ndodh nëpërmjet filtrimit dhe bllokimit të përmbajtjes, duke na penguar t'i qasemi informacionit lirshëm. Sidoqoftë, përmbajtja mund të redaktohet jo vetëm përmes censurës, por edhe vendosjes së saj, d.m.th algoritmet mund të vendosin se cili lloj i përmbajtjes do të jetë i dukshëm për cilin përdorues. Rrjedhimisht, përderisa krijohen forma të reja të komunikimit, numri i mënyrave për t'i kufizuar ato gjithashtu rritet dhe mbrojtja e lirisë së shprehjes në kontekstin dixhital mund të jetë veçanërisht sfiduese.

### SHEMBUJ TË SHKELJEVE TË TË DREJTAVE

- Një gazetare nga një media online u arrestua në shtëpinë e saj për një artikull në të cilin shkruante për kushtet e këqija të punës dhe mungesën e pajisjeve mbrojtëse për punonjësit e mjekësisë gjatë pandemisë COVID-19. Ajo u ndalua nga policia për 48 orë dhe spitali njoftoi se gazetarja po përhapte informacione të rreme dhe po shqetësonte opinionin.
- Administratorët e një grupi në Facebook, në të cilin ishte postuar një foto e një tufe delesh me mbishkrimin "Këshilltarët bashkiak", u gjobitën pasi gjykata vendosi se postimi i tyre ishte fyes dhe poshtërues.
- Deputeti i një vendi fyti disa politikanë me mesazhe seksiste dhe vulgare në Twitter, bëri thirrje për përdhunimin e një zyrtari dhe kërcënoi se do të qëllonte kundërshtarët e tij politikë.
- Pasi një aktiviste e të drejtave të njeriut mbrojti një person të ekspozuar ndaj sulmeve shoviniste, ajo vetë u bë viktimë e kërcënimeve dhe sulmeve përmes rrjeteve sociale. Për shkak të ndjenjës së pasigurisë ajo ka bërë disa kallëzime penale, por reagimi i autoriteteve ka munguar dhe kërcënimet kanë vazhduar.

- Një rrjet social njoftoi se në disa vende kishte fshirë mijëra llogari të rreme, të ashtuquajtura "bot", të cilat shërbenin për të promovuar partitë në pushtet.
- Identitetet e disa mediave online u vodhën dhe u kopjuan duke krijuar faqe me domen dhe dizajn pothuajse identik, të cilat më pas u përdorën për të promovuar punën e partisë në pushtet dhe për të ngatërruar lexuesit e rregullt të atyre mediave.

## PASOJAT PËR INDIVIDIN DHE SHOQËRINË

Mungesa e lirisë së shprehjes dëmton të gjithë shoqërinë pasi që ajo pengon ata të kenë qasje në ide apo informacione të ndryshme që mund të jenë me rëndësi publike, d.m.th të cilat mund të çojnë në përparim ose të vënë në dukje probleme të caktuara sociale. Nga ana tjetër, liria e shprehjes përfshin edhe rregullimin e manipulimit dhe shpërndarjes së mundshme të informacionit të rremë. Kufizimi i lirisë së fjalës në formën e luftimit të gjuhës së urrejtjes, kërcënimeve, nënçmimit etj. është gjithashtu vendimtar, pasi një fjalim i tillë mund të provokojë ose shtojë numrin e akteve të dhunës dhe diskriminimit, të dëmtojë reputacionin dhe dinjitetin ose të kërcënojë ndjenjën e lirisë dhe sigurisë së individëve, heshtjen e anëtarëve të grupeve minoritare dhe reduktimin e kohezionit të shoqërisë në tërësi.

## MEKANIZMAT PËR MBROJTJE

- Interneti na lejon të jemi jo vetëm përdorues, por edhe prodhues të përmbajtjes, dhe kjo duhet mbajtur parasysh kur në shoqërinë tonë ndodhin gjëra që mund të censurohen (p.sh. protesta).
- Nëse ka përmbajtje të paarritshme në vendin ku jetojmë, ne mund t'i qasemi asaj përmes p.sh. shfletuesit Tor, i cili na lejon anonimitet dhe qasje falas në internet.
- Nëse mendojmë se disa faqe në internet do të jenë të paarritshme ose do të fshihen në të ardhmen, ne mund t'i ruajmë ato duke përdorur mjete si Wayback Machine. Ky mjet është bërë nga Arkivi i Internetit, një bibliotekë dixhitale qëllimi i së cilës është qasja universale në të gjitha njohuritë.
- Nëse dikush na fyen, na kërcënon ose kërcënon të drejtat tona personale, ne duhet të informojmë komunitetin tonë, të bllokojmë dhe të

raportojmë personin në fjalë në rrjetet sociale. Nëse sulmet vazhdojnë, ne duhet t'u drejtohem autoriteteve kompetente dhe të insistojmë në ndihmë dhe mbrojtje ligjore.

- Një mënyrë për t'iu përgjigjur heshtjes është të flisni edhe më shumë! Nëse kemi heshtur për shkak të disa kritikave ose mosmarrëveshjeve, informimi i publikut të gjerë mbi problemin mund të na kthejë një ndjenjë kontrolli mbi situatën.
- Nëse jemi viktimë e gjuhës së urrejtjes, p.sh. sulmit verbal me bazë racore, fetare, kombëtare, seksuale, politike, sindikale apo ndonjë përkatësie ose karakteristike tjetër personale, ne duhet të kontaktojmë një nga institucionet përgjegjëse, si policinë apo Komisionerin për Mbrojtjen e Barazisë.

Në këtë [vegëz](#) ju mund të shikoni videon tonë të shkurtër mbi lirinë e shprehjes.



## TË DREJTAT DIXHITALE NË RAJON

Fondacioni SHARE ka vendosur monitorim të vazhdueshëm të të drejtave dhe lirive të qytetarëve në mjedisin dixhital dhe vazhdimisht publikon raporte të rregullta vjetore të gjetjeve të tij. Procesin e monitorimit dhe dokumentimit të shkeljeve të të drejtave dixhitale SHARE e filloi në Serbi në vitin 2014, dhe në vitin 2019 në bashkëpunim me BIRN procesi u zgjerua edhe në rajon, ku aktualisht përfshinë Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Hungarinë, Rumaninë, Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ky proces, përveçse na lejon të paralajmërojmë dhe mobilizojmë publikun, gjithashtu na fuqizon të marrim pjesë aktive në avokimin e propozimeve të reja ligjore dhe në analizën kritike të atyre egzistuese, që kanë të bëjnë me rregullimin e jetës së individëve, e të cilat po zhvillohen si në hapësirat fizike ashtu edhe në ato dixhitale.

Ju mund t'i qaseni bazës së të dhënave të shkeljeve të të drejtave dixhitale në këto 6 vende në këtë [vegëz](#).

Në këtë [vegëz](#) mund të gjeni një studim mbi rregulloret në tre fusha të mbuluara nga ky udhëzues, duke përfshirë gjashtë vendet e rajonit si: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Fondit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve, USAID-it apo të Qeverisë së SHBA-ve.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy  
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND